



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT GJIROKASTËR
NJËSIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. _____ Prot.

Gjirokastrë, më ____.

**SHPALLJE PËR LËVIZJE PARALELE
PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL
NË KATEGORINË EKZEKUTIVE**

Në zbatim të Nenit 22, të Ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, si dhe të Kreut II dhe III, të VKM Nr. 243, datë 18/03/2015 i ndryshuar, Keshilli i Qarkut Gjirokastrë shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të ngritjes në detyrë për pozicionin

- 1. Specialist në Zyrën e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës Tepelenë,**
- 2. Specialist në Zyrën e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës Përmet,
Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës**

Pozicioni më sipër, i ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele.

Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet pranim ne pranimin civil ne kategorine ekzekutive.

**PËR TË DY PROCEDURAT (LËVIZJE PARALELE, PRANIM NE SHERBIMIN
CIVIL) APLIKOHET NË TË NJËJTËN KOHË**

Afati për dorëzimin e dokumentave për:

Lëvizje Paralele

27.02.2023

Afati për dorëzimin e dokumentave për:

Pranim në shërbimin civil

02.03.2023

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

- Përgjigjet për zbatimin e dispozitave ligjore, për administrimin e tokës bujqësore, si dhe të kategorive të tjera të resurseve të përcaktuara në Ligjin Nr. 8752, datë 26,03,2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”;
- DAMT-ja, për realizimin e funksionit të saj si kadastrë e shumëqëllimshme, mban dhe ruan, me inventarizim, dokumentacionin kadastral ekzistues që disponohet pranë saj, pavarësisht nga koha e krijimit të tij:
 - Librat e tokës dhe librat e ngastrave,

- Planimetri të ndryshme kadastrale,
- Çdo hartë kadastrale dhe topografike të shkallëve të ndryshme,
- Dokumenta në të cilat evidentohen pasuritë private apo shtetërore “Për reformën agrare”,
- Dokumenta që kanë objekt fondin e tokës bujqësore si dhe dokumentacion të ndarjes së tokës bujqësore, të cilat mbahen dhe ruhen në këtë drejtori;

1. LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a- Të jenë nëpunës civilë të konfirmuar, brenda së njëjtës kategori IV-a;
- b- Të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
- c- Të kenë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”.

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- a. Të zotërojnë diplomë të nivelit "Bachelor", në një nga fushat Agronom/ Gjeodet/ Gjeograf / Ekonomist.
- b. Të ketë të paktën 1 vit eksperiencë pune.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DOREZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë me postë në adresën: Këshilli i Qarkut Gjirokastër, Rruga “Ismail Kadare”, Gjirokastër.

ose dorazi në zyrën e Protokoll-Arshivës pranë Këshillit të Qarkut Gjirokaster:

- a. Jetëshkrim (CV);
- b. Fotokopje të diplomës. Për diplomat e mara jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
- c. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- g. Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h. Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- i. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave për lëvizjen paralele duhet të bëhet brenda datës 27.02.2023.

1.3 REZULTATET E VERIFIKIMIT PARAPRAK TË KANDIDATËVE

Në datën **01.03.2023**, Keshilli i Qarkut Gjirokastrë do të shpallë në portalin “e AKPA (<https://www.puna.gov.al>). listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e lëvizjes paralele, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë kur do të zhvillohet intervista.

Gjithashtu, po në këtë datë kandidatët që nuk janë kualifikuar do të njoftohen nga Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore për shkaqet e moskualifikimit, nëpërmjet email-it të tyre.

1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Intervista do të zhvillohet në ambjentet e Këshillit të Qarkut Gjirokastrë.

Gjatë intervistës kandidatët do të vlerësohen në lidhje me njohuritë mbi:

- Ligjin Nr. 8752, datë 26.3.2001, “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për Administrimin dhe Mbrojtjen e Tokës”, i ndryshuar;
- VKM Nr.121, datë 17.02.2011 “Për mënyrat e ushtrimit të funksioneve nga drejtoritë e administrimit dhe mbrojtjes së tokës në qarqe dhe zyrat e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës në Komuna/Bashki”;
- Ligjin Nr. 9244, datë 17.6.2004, “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”;

1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen nga komisioni i ngritur pranë Këshillit të Qarkut Gjirokastrë. Kandidatët do të vlerësohen për jetëshkrimin, eksperiencat, trajnimet, kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe vlerësimet pozitive.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Struktura e ndarjes së pikëve të vlerësimit të kandidatëve është, si më poshtë vijon:

- a) 40 pikë për dokumentacionin e dorëzuar, i ndarë: 20 pikë për përvojën, 10 pikë për trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën përkatëse, si dhe 10 pikë për certifikimin pozitiv;
- b) 60 pikë intervista me gojë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike “eëë.dap.gov.al”

Kandidati që merr më pak se 70 pikë nuk konsiderohet i suksesshëm.

1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Këshilli i Qarkut Gjirokastrë do të shpallë fituesin në portalin e AKPA (<https://www.puna.gov.al>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet nëpërmjet adresës së e-mail.

2. PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL.

Vetëm në rast se ky pozicion në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil. Këtë informacion do ta merrni në portalin e AKPA (<https://www.puna.gov.al>).

KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NE SHËRBIMIN CIVIL DHE KRITERET E VEÇANTA

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit ne shërbimin civil janë:

- a- Të jetë shtetas shqiptar;
- b - Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c - Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d - Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e - Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- f - Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a) Të zotërojnë diplomë të nivelit "Bachelor", në një nga fushat Agronom/ Gjeodet/ Gjeograf/ Ekonomist.

2.1 DOKUMENTACIONI, MENYRA DHE AFATI I DOREZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a. Jetëshkrim (CV).
- b. Fotokopje të diplomës. Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
- c. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- g. Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h. Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- i. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave për procedurën e pranimit në shërbimin civil duhet të bëhet brenda datës: **02.03.2023**

2.2 REZULTATET E VERIFIKIMIT PARAPRAK TË KANDIDATËVE

Në datën **03.03.2023**, Këshilli i Qarkut Gjirokastrë do të shpallë në portalin e AKPA (<https://www.puna.gov.al>), listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e pranimit në shërbimin civil, datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e pranimit në shërbimin civil, do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga KQGJ, për shkaqet e moskualifikimit (*nëpërmjet adresës së e-mail*).

2.3 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA

Kandidatët do të testohen me shkrim në lidhje me njohurite mbi:

- Ligjin Nr. 8752, datë 26.3.2001, “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për Administrimin dhe Mbrojtjen e Tokës”, i ndryshuar;
- VKM Nr.121, datë 17.02.2011 “Për mënyrat e ushtrimit të funksioneve nga drejtoritë e administrimit dhe mbrojtjes së tokës në qarqe dhe zyrat e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës në Komuna/Bashki”;
- Ligjin Nr. 9244, datë 17.6.2004, “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”;

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

2.4 MËNYRA E VLERESIMIT TE KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- deri në 15 pikë për dokumentacionin e dorëzuar
- b- deri në 60 pikë për vlerësimin me shkrim
- c- deri në 25 pikë për Intervistën e strukturuar me gojë

2.5 DATA E DALJES SE REZULTATEVE TE KONKURIMIT DHE MENYRA E KONKURIMIT.

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, KQGJ do të njoftojë ata individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail). KQGJ do të shpallë fituesin në portalin e AKPA (<https://www.puna.gov.al>).

- Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit ne sherbimin civil, do të marrin informacion në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” për fazat e mëtejshme të kësaj procedure:
- Për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak; datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;

K R Y E T A R

Lindita Rova

Punoi:
Miratoi: